

FJALA E DEPUTETES MIRELA KUMBARO

E HËNË 5 DHJETOR 2022

Të nderuar kolegë,

Të nderuar ju që na ndiqni përmes ekranit,

Jam këtu për një interpelancë urgjente, e theksoj urgjente, kështu thoshte letra, dhe arsyeja është për një monedhë 50 lekëshe, sepse kaq është çmimi i biletës individuale për të hyrë në çdo park kombëtar, zonë të mbrojtur, me infrastrukturë të dedikuar për vizitorët. Edhe në Parkun e Kombëtar të Divjakës me 50 lekë ju mund të vizitoni qendrën e vizitorëve; muzeun e vogël natyror aty brenda; mund të vëzhgoni shpendët e egra; mund të frekuentoni shtigjet natyrore; mund të bëni vizita me udhërrëfyes të parkut; mund të vëzhgoni flamengot, mjellmat në lagunë apo florën e pasur të parkut.

Nëse në park hyjnë me makinë 5 veta, siç ndodh rëndom në park, çmimi bëhet 150 lekë, pra 30 lekë për person. Ky çmim ulet akoma më shumë, pra, nëse vizitorët janë në grup prej 10 vetash, bileta është 200 lekë për të gjithë bashkë, pra 20 lekë për person. Nëse do të jetë një grup edhe më i madh prej 20 vetash, çmimi bëhet 250 lekë, pra 12,5 lekë për person; nëse do të jetë një grup edhe më i madh, për shembull një autobus turistësh apo vizitorësh me 50 veta, çmimi është 300 lekë të rinj për të gjithë pasagjerët bashkë, pra 6 lekë të rinj për person.

Tani nuk i kam 6 lekë, sepse nuk e gjeta një monedhë të tillë, por, nëse dikush mendon se këto çmime i shpik unë, gabohet, është vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1156, datë 24 dhjetor 2020, që i ka vendosur këto tarifa dhe titullohet: “Për përcaktimin e të ardhurave të gjeneruara nga tarifat që paguhen në zonat e mbrojtura, të masës dhe kritereve të përdorimit të tyre”. Kjo është VKM-ja e dhjetorit të vitit 2020.

Ju, zonja Dhori, keni bërë edhe një kërkesëpadi në gjykatë për këtë punë, por sot gjykata e ka rrëzuar, ndaj do të ishte në nderin tuaj ta tërhiqnit atë kërkesëpadi. Po i kthehem VKM-së. Kjo VKM ka dalë në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 81 të vitit 2017 “Për zonat e mbrojtura”. Në nenin 57 të këtij ligji flitet për burimet e financimit dhe administrimit të zonave të mbrojtura dhe thuhet: “Menaxhimi i zonave të mbrojtura mjedisore financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme”.

Pika 2: “AKZM-ja është e përgjegjshme për administrimin e të gjitha të ardhurave të realizuara nga aktiviteti ekonomik në territorin e zonave mjedisore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi”. Në nenin 58 të po këtij ligji flitet për përdorimin e të ardhurave të siguruar në zonat e mbrojtura dhe në pikën 2 të tij thuhet: “Të ardhurat e siguruar në zonat e mbrojtura mjedisore, sipas pikës 1 të këtij neni, janë të ardhura nga tarifat që paguajnë vizitorët e turistët që vizitojnë zonën; nga tarifat që paguhen për ushtrimin e veprimtarive që kryhen në zonat e mbrojtura; nga vlerat monetare të zhdëmtimeve që paguajnë dëmtuesit e zonës; nga donacionet e ndryshme e të tjera”.

Për të gjithë ata, që nuk e dinë përse duhen këto të ardhura, jo për gjë, por na gënjen mendja, se krenohemi me Divjakën, e gëzojmë atë dhe mendojmë se mbahet me frymën e shenjtë. Qetësohu, qetësohu. Po e shpjegoj për çfarë përdoren këto para. Të ardhurat e administruara, sipas pikës 2 të nenit 58, përdoren nga AKZM-ja për investimet në zonat e mbrojtura; për përballimin e shpenzimeve për punësime sezonale; për hartimin e planeve të menaxhimit dhe të inventarizimit të pyjeve, kullotave, florës dhe faunës së egër; përdoren për projektet e pyllëzimit; për përmirësimet e territorit; për luftën kundër gërryerjeve dhe erozionit; për të hapur shtigjet në zonat e mbrojtura; për luftimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve; për masat e parandalimit dhe mbrojtjen nga zjarri; për mbarështimin; për ushqimin dhe për sigurimin e kushteve të jetesës për faunën e egër; për masat e parandalimit të erozionit; për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës brenda zonave të mbrojtura; për transportin dhe mjetet e tjera; për përmirësimin e kushteve të punës; për uniformat.

Madje, mund t’ju them se jo më lag se dje, për shkak të motit, ishin bllokuar një pjesë e shtigjeve, dhe në orare kur ne të gjithë pushonim, punonjësit e Agjencisë Rajonale ishin në territor për ta pastruar parkun dhe për ta bërë të vizitueshëm. Pra, përdoren edhe për publikimet, për ndërgjegjësimin, për edukimin dhe informimin për rehabilitimin e habitateve e kështu me radhë. Kjo VKM sqaron përse përdoren të ardhurat. Kjo VKM zbatohet tashmë pa asnjë problem apo kundërshti në Parkun Kombëtar të Dajtit, në Parkun Kombëtar të Kune-Vainit në Lezhë, në Parkun Natyror të Syrit të Kaltër dhe në Finiq. Përgjithësisht biletat ishin manuale, pra priteshin me dorë.

Sot kemi biletari elektronike, njësoj siç i kemi instaluar edhe në parqet e arkeologjike, në disa prej muzeve kombëtare, madje edhe në kalanë e Gjirokastrës e kemi një të tillë. Falë projektit të përbashkët me PNUD-in, që quhet “Rritja e qëndrueshmërisë financiare të sistemit të zonave të mbrojtura në Shqipëri”, blerja dhe instalimi i këtyre biletarive bashkëfinancohet nga fondet e Kombeve të Bashkuara dhe nga fondi global i mjedisit. A e dini përse? Sepse në vitet 2016- 2017 qeveria shqiptare ka negociuar

gjatë dhe ka miratuar një marrëveshje me të gjitha agjencitë e Kombeve të Bashkuara të pranishme në Shqipëri për t'u angazhuar për realizimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.

Në objektivin nr. 15 të kësaj marrëveshjeje ndërkombëtare thuhet: “Kemi detyrë mbrojtjen, rimëkëmbjen dhe nxitjen e përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore dhe ujore; ndalimin dhe prapësimin e procesit të degradimit të tokës, si dhe ndalimin e humbjes së biodiversitetit”. Kjo marrëveshje e angazhon shtetin shqiptar me detyrën për të kapërcyer sfidat e mëdha të së ardhmes dhe mangësitë e trashëguara (po flas për vitin 2016) për realizimin e këtij objekti. Po citoj marrëveshjen e vitit 2017: “Sfidat përfshijnë mungesën e burimeve financiare, kapacitetin e ulët administrues, mungesën e zbatimit të ligjit, mungesën e personelit shkencor të kualifikuar, përfshirjen e pakët të komunitetit në mbrojtje dhe mungesën e besimit të administrata vendore”.

Ndaj, falë këtij bashkëpunimi, u hartua ligji për zonat e mbrojtura dhe u miratua në vitin 2017. U konsolidua Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, që u krijua në vitin 2015 (i mbani mend datat), dhe u pajis me 12 agjenci rajonale, ku punojnë vajza e djem me pasion e përkushtim dhe gjatë gjithë kohës janë në shërbim të natyrës në tokë dhe në ujë; punojnë në shërbim të faunës, të florës, sidomos të komunitetit, të vizitorëve, turistëve dhe fëmijëve, me të cilët bëjnë programe edukimi në luftë me zjarret, me dëmtuesit dhe me erozionin.

Qeveria shqiptare me agjencitë e Kombeve të Bashkuara dhe partnerë të tjerë kombëtarë kanë rënë dakord dhe kanë bashkëfinancuar jo vetëm biletaritë elektronike për të siguruar administrimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura, por edhe qendrat e vizitorëve në Divjakë, në Dajt, në Llogora e kështu me radhë, për plane menaxhimi dhe për shtigjet për turistët. Pjesë e këtij bashkëpunimi është edhe edukimi i publikut, që të bëhet jo vetëm përfitues i kënaqësive që ofrojnë zonat e mbrojtura, por edhe kontribues. Këto qindarka, që kam këtu, janë një gjest simbolik për këtë gjë, pra bëhet fjalë për 50 lekë, që janë më pak se 50 cent. Gjatë viteve të fundit fluksi i turistëve në zonat e mbrojtura është rritur ndjeshëm, po kështu edhe në parkun Divjakë-Karavasta ky numër ka ardhur në rritje; edhe më shumë do të rritet, duke sjellë nevojën për një menaxhim më të mirë të flukseve.

Kjo ka nevojë të bëhet jo me metoda primitive, por me sistem elektronik të biletave, sepse, përveçse sigurohet transparencë, bëhet i mundur edhe kontrolli i fluksit të vizitorëve, i mjeteve motorike e kështu me radhë, sepse jemi në park kombëtar dhe duhet shkalla më e lartë e mbrojtjes. Këtu nuk bëhet fjalë të paguajnë punonjësit që punojnë në subjektet private aty brenda, as peshkatarët dhe as banorët, përkundrazi, këtë e kemi deklaruar që ditën e parë. Ua kemi bërë të qartë subjekteve, bashkisë, dhe po

e përsëris, nuk bëhet fjalë që të paguajnë punonjësit, të cilët punojnë në subjektet private, as peshkatarët dhe as banorët e zonës. Të përpiqesh të shurdhosh këtë informacion me gënjeshtër shpifje, zhurmë e pështyma virtuale është mjerane.

Për të gjithë ata, që i kemi parë këtë javë të bërtasin para kamerave si përfaqësues të opozitës, duke halucinuar se parku do të privatizohet, se po i vjedhim banorët, se po gënjejnë punonjësit, se kjo punë është e paligjshme, siç e bëtë edhe pak më parë, duhet të jetë një hall i madh, më besoni, kur ju e dini shumë mirë që nuk është ashtu, por është kështu siç po them unë. Madje, zonja Dhori, ju kam dërguar edhe një përgjigje të gjatë shteruese, me shkrim për të gjitha këto që thatë, por vetëm ju e dini pse i thoni këto broçkulla. Ju qofshi! Për informacionin tuaj, brenda parkut janë rreth 90 objekte, pjesa më e madhe e të cilëve janë ndërtuar në vitet e tranzicionit, herë me leje e herë pa leje; rreth 50 prej tyre janë funksionale, hotele, restorante dhe bare.

Në asnjërën prej tyre nuk e pi dot një kafe 50 lekë, sepse janë më shumë sesa 50 lekë, por turistët vendas e të huaj, që frekuentojnë dhe shpenzojnë për të konsumuar dreka, darka në restorante private, jam e bindur se nuk do t'i kursenin 50 lekë, 20 lekë apo 10 lekë për ta administruar më mirë Parkun Kombëtar të Divjakës, as nuk do të tërhiqen te biletaria përpara pak qindarkave, as nuk do të heqin dorë nga shëtitja, as nga plazhi, as nga dreka, kur të mësojnë se duhet të paguajnë disa qindarka për të kontribuar për mirëmbajtjen e një prej zonave më të vyera të ekosistemit. Siç më tha para pak ditësh një kolegu im i opozitës këtu në parlament: “Ma shpjego pak, se nuk po e kuptoj këtë “furtunë në gotë”?

Unë e kam vizituar Kune-Vainin dhe më pëlqen shumë. Për të thënë të vërtetën, me shumë dëshirë do t'i jap ato 50 lekë aty”. E, pra, as unë nuk e kuptoj. Akses i kontrolluar në park, përveç sigurimit të të ardhurave, do të ndihmojë edhe në menaxhimin efektiv dhe të qëndrueshëm në këtë zonë të mbrojtur mjedisore. Vendosja e kontaktit të drejtpërdrejtë të të gjithë vizitorëve me stafin e parkut te biletaria do të ndihmojë që të kontrollojmë fluksin turistik, të kuptojmë se cilat janë arsyet pse vijnë vizitorët, t'i orientojmë ata në përputhje me zonimin dhe rregullat e parkut. Janë momente të vogla edukimi, për të cilat kemi kaq shumë nevojë. Rruga, ku vendoset sistemi i kontrollit, është një rrugë që jep akses vetëm në park dhe nuk të lidh me asnjë aks tjetër rrugës. Ajo është nën administrimin e ARRSHsë, e cila ka dhënë tashmë lejen për instalim.

Kudo në botë parqet kombëtare mirëmbahen, promovohen në mënyrë të veçantë, për shkak të frekuentimit të lartë të turistëve, madje ka të tilla që e kanë të kufizuar numrin ditor të vizitorëve për të mos prishur habitatet e faunës dhe të florës. Ne kemi shumë raste në Shqipëri, ku praktika e tarifave

hyrëse aplikohet normalisht jo vetëm në Dajt, në Syrin e Kaltër, në Kune-Vain, por është rutinë edhe në parkun e Orikumit, edhe në atë të Finiqit, edhe në Apolloni, edhe në Amantia dhe në shumë site të tjera. Kështu ka qenë, kështu është dhe kështu duhet të jetë. As nuk kishim parë, as nuk kishim dëgjuar që të ngrihet opozita e t'i ngrëjë mendjen dynjasë kundër biletës 50 lekë për turistët, jo për banorët dhe punonjësit.

Edhe një herë: banorët përjashtohen nga tarifa, e cila për turistët është simbolike, por VKM-ja e vitit 2020 e ka konsideruar të mjaftueshme për ta përdorur për pastrim, mirëmbajtje dhe investim në zonë, çka do të sjellë më shumë vizitorë, më shumë të ardhura për zonën dhe për banorët. Ai, që quhet me përçmim "trau", nuk është gjë tjetër veçse biletaria elektronike, që garanton transparencë dhe miradministrim. Tani pak historik Parku i Divjakës ka pasur biletë hyrjeje deri në vitin 2011 dhe ka qenë 1 mijë lekë, pra 100 lekë të rinj, sa dyfishi i kësaj monedhe. E aplikonte bashkia, ka qenë 10 lekë, pra të mos bëjmë sikur lindëm sot, pavarësisht respektit për moshën e re të koleges, dhe sikur po flasim për ndonjë gjë të paparë e të padëgjuar ndonjëherë.

Shkoni e pyetini banorët e vjetër ose ishkrjetarin e bashkisë të vitit 2011, se e keni dhe të partisë suaj, si e kishte biletën, sa lekë, të cilën edhe e aplikoi! Zoti Alibeaj nuk është këtu, por është bashkëfirmues i kësaj interpelance. Në interpelancën tuaj i referoheni edhe një vendimi gjyqësor. Zoti Alibeaj nuk është këtu dhe nuk do ta vazhdoj mesazhin që kisha drejtpërdrejt me të, por nuk e di se si mund t'i referoheni në një interpelancë një vendimi gjyqësor dhe të mos merrni mundimin ta lexoni atë. Mos më thoni se e keni lexuar dhe pastaj e keni futur duke e ditur. Ai vendim gjykate i shkallës së parë i vitit 2011, që e përmendni, dhe ai i apelit të vitit 2013 thotë pikërisht këtë që po them unë, ose më saktë këtë që thotë ligji, të cilit iu referova.

Citoj vendimin, që ju i referoheni në kërkesën për interpelancën tuaj tmerrësisht urgjente. Ky ekosistem natyror, - thotë vendimi i gjykatës, - është në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve, që sot korrespondon me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura. Gjykata vazhdon: "Tarifat hyrëse për shfrytëzimin e ekosistemit natyror Divjakë - Karavasta, meqenëse është park kombëtar, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave". Jua tregova vendimin e Këshillit të Ministrave. Ja ku është! Këtë vendim e kemi sot. Gjithashtu, arsyetimi i vendimit në gjykatë vijon: "Eksperti i thirrur nga gjykata ka sqaruar se rruga ku është vënë postblloku (bëhet fjalë për postbllokun e vitit 2011 nga kryetari i bashkisë për vitin 2011, që është po i partisë suaj).

Meqenëse nuk e besoni këtë që po them unë, prandaj dhe i gjithë territori dhe kjo rrugë hyrëse është pjesë e Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta”. Është interesante, se gjykata e njeh dhe e pranon qëllimin e mirë të vjeljes së tarifës, pavarësisht se kush e vjel nga ana e bashkisë. Citoj: “Nevojitet për mirëmbajtjen e zonës”, por thjesht e gjen këtë tarifë hyrëse, të vjelë nga bashkia, në tejkallim të kompetencave të bashkisë, sepse është kompetencë e Agjencisë së Zonave të Mbrojtura. Është Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura që, në bazë të VKM-së dhe të ligjit “Për zonat e mbrojtura”, sot, siç aplikon në Dajt, në Syrin e Kaltër, në KuneVain, do të aplikojë edhe në Divjakë për të hyrë në park. Kaq e thjeshtë është, të dashur shoqe dhe shokë; e mbarsët malin.

Po mirë, të dashur kolegë! Nëse nuk më pranon për shoqe, i dashur koleg... Po, mirë, aty të ngeltë halli! E mbarsët malin dhe Divjakën e prodhuat ca qindarka, të cilat po jua lë këtu: 10, 20 dhe 50, se kaq është bileta hyrëse në Parkun Kombëtar të Divjakës, jo vetëm për të ngrënë dhe për të pirë, por na bëni edhe ndonjë vizitë te qendra e vizitorëve në Divjakë, se me siguri nuk e keni parë asnjëherë. Jua bëj këtë ftesë sot, në Ditën Botërore të Tokës. Gëzuar! Ju mirëpres, kur ta instalojmë tamam atë biletarinë elektronike, në zbatim të ligjit. Shumë faleminderit! T’i lashë këtu. I ke monedhat gati për të gjitha biletat.